Me të vërtetë gjendemi përballë një njeriu, përballë një Françeskani të denjë, përballë një meshtari katolik, por gjithashtu gjendemi edhe përballë atij që diti të dëshmojë, diti të shkruajë, ai diti të na japë Fjalën, diti të japë ide ndryshe nga modat apo rrymat e momentit. Kjo është fjala më e fortë e cila flet me jetë, sepse Historia më pare shkruhet me jetë dhe pastaj me pendë, nëse nuk e ndryshojnë ata që kanë pushtetin. Sidomos në një botë ku sundon antilogjika, e cila i zë vendin arsyes saqë errëson çdo mendim të ndritur.

At' Zefi e kishte shumë të qartë kujtimin e vendeve ku kishte jetuar të cilat me vonë u kthyen në vende persekutimi të të pafajshmëve. Ja si shprehet ai në një letër që mund ta quajme "Testamenti i tij Shpirtnor": Sot po e merrni ju n'dorzim kët shtëpi lutjesh e uratet, por nga thellësia e kohëve të kalueme, un si trashigimtar i fundit i atyne brezave fretënish, po u la kët amanet e kët porosi: Ruenje me kujdes kët vend e shtëpi t' shejtë! Rueni kujtimet e atyne që kjenë ktu përpara jush! Ata kjenë që i prinë këtij populli të mjerë me dritën e fesë e të përparimit, e ju rueni sot e mbrapa jo vetëm gjurmët e tyne, por edhe shpirtin e tyne! Kujtoni gjithmonë se në kët shtëpi e në kët ambient kanë shkri të gjitha fuqitë e mendjes dhe të shpirtit fretënit ma të aftet që pat Provinca Françeskane e jona, P. Vinçens Prendushi, P. Anton Harapi, P. Marin Sirdani, P. Justin Rrota, P. Donat Kurti e t'tjerë e tjerë që kjenë drita e ktij populli". Me siguri At' Zefi do të ketë bërë edhe gabime, por 25 vjet burg të bëra për dashuri dhe për t' i qëndruar besnik deri në vdekje Atij që është dashuria, d.m.th.



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLUMI**

**30**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

Krishtit, ia shlyejnë shumë lëshime. Jo vetëm kaq, Ai jeton tashmë në jeten e vërtete, jo në sajë të meritave të tij, por sepse qe larë me gjakun e Fjalës së bërë Njeri, Jezu Krishti, që duke vdekur fitoi. Ja pse krejt jeta e At' Zefit merr një kuptim krejt tjetër dhe të ri, sepse duke humbur fitoi, ja pse vepra e tij është domethënëse. Ai kërkon ndjesë:

A thua mekatnuam? ...Nuk e dij, por kështu kje koha e jonë. U kërkojme falje për shka kemi gabue, por na ashtu gjykonim kur nuk kish kurr fare gjukimi. U kërkojme falje në kjoftë se duruam shumë apo nëse nuk e çuam zërin më shumë për drejtësi.

Ai e dinte fare mirë edhe fuqinë e lutjes dhe të ndërmjetësismit, kështu shprehet: "Amanet po ua la: lutnju për Provincen Françeskane Shqiptare, lutnju shumë e gjithmonë. Lutnju që shpirti i shën Françeskut të vazhdojë me i pri gjithnji këtij populli që gjindet gjithnji mes stuhish e uraganesh të shekullit. Lutnju gjithmonë e Zoti i Madh e ndigjofte lutjen tuej".

Ai ishte Meshtar, prift i Kishës Katolike. Zgjodhi, ose më mirë e zgjodhi vetë Zoti që t' i shërbente atij dhe popullit në këtë mënyrë, duke qenë i vetëdijshëm se pa Meshtarë, na mungon udhëheqja, na mungon Krishti, sepse është ai që vepron në personin e Krishtit. Prandaj shën Françesku thotë: "Nëse do të takoja njëkohësisht një engjëll dhe një Meshtar, Prift, do të përshëndesja në fillim Meshtarin, sepse ai është një tjetër Krisht". Ky është shërbimi më i përkryer që i bëri këtij kombi, i dha të vërtetën. Nëse nuk i jep të vërtetën, ai ecën në gënjeshtëri, nëse nuk i jep shpresën, ai ecën në humbje, nëse nuk i jep fenë, ai ecën në zhgënjime; nëse nuk i jep Zotin, nuk i kë dhënë më të domosdoshmen që i nevojitet për jetë. Një popull zhvillohet dhe përparon kur ushqehet me doktrinën dhe moralin e shëndoshë qe ne e quajmë "të krishterë". Ai i bashkohet zërit të lutjes së mbrame të bashkëvëllezërve të tij si, At' Mati Prendushi e At' Çierian Nika duke thanë: "O Zot, na po desim pa faj, por fali ata që na gjykojnë si edhe ata që na pushkatojnë.

"Rrnoftë Krishti mbret e rrnoftë Shqipnia".



Nga Prof/ As. Dr.  
Ardian NDRECA



**AT ZEF  
Pllumi**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**31**

## HISTORIA SI PREMTIM NDAJ SË VËRTETËS

**A**t Zef Pllumi ua ka kushtue veprën e tij “Rrno vetëm për me tregue” - “Atyne që vdiqën njerz, atyne që qëndruen njerz gjatë asaj periudhe të vështirë, në të cilën njeriu u shndrrue në kafshë pune”. Vetëm kur mendon se pati prej atyne që jetuen njerz, vdiqën njerz, qëndruen njerz, mundesh mos me pranue at thanjen sarkastike të filozofit gjerman Arthur Schopenhauer: historia asht një vijim i zoologjisë. Nën regjimin që dënoi, burgosi, poshtnoi, torturoi P. Zefin e mija e mija të tjerë - historia jonë rrezikoi me të vërtetë me u kthye në zoologji. Ata që iu kundërvunë asaj ideje dhe paguen për at’ guxim qenë njerzit që e fituen luftën. Historinë e vërtetë e shkruajnë vetëm njerzit, pse histori ka vetëm ai që përshkon kohën që i asht caktue me vetëdije dhe tue qenë i lirë mbrenda vetes.

Kjo asht arsyeja pse sot shqiptarëve nuk u mjafton ma historia e zoologjisë që u asht servir për dekada por kërkojnë një histori njerzore, ku të pasqyrohet



**AT ZEF  
PLLUMI**

**32**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

mbijetesa e vështirë e lirisë ndër shpirtinat e tyre. Nuk mund të mohohet se për një gjysmë shekulli një popull i tanë asht mshehë dhe ka refuzue përgjegjshinë morale përpara historisë së vet. Asht mshehë mbas justifikimeve se shtërngimi dhe dhuna s'lejonin asnjë mundësi tjetër. Për këtë epokë të errtë rrëfëhet At Zef Pllumi, të cilin jeta e përpoqi me njerëz që jetonin në rrethana ku virtytet mbaheshin të mshehuna, kurse veset ishin të dukshme. Ai vetë, në thjeshtësinë e tij, mund të konsiderohet si një fenomen mjaft i rrallë për kohën në të cilën jetoi. Asht paradoksal fakti, por regjimi i E. Hoxhës paraqitej si një fe e re dhe kërkonte prej njerzve me besue me zor në mrekullina.

Disa prej dogmave që duhet të besoheshin me detyrim ishin, për shembull: përparimi i vendit, liria dhe demokracia, mirëqenja e naltë, forca e ekonomisë socialiste, fuqia ushtarake e vendit, mirësia absolute dhe largpamësia e pashoqe e shokut Enver. Paradoksi qëndron në faktin se në anën tjetër, një frat i vorfën, i panënshtuem, që besonte në lirinë e personit, na tregon realitetin me rrëfimet e tija të thjeshta e plot dritë. Me lexue veprën e françeskanit tonë domethanë me kuptue diçka rreth nevojës që kemi pasë dhe kemi ende sot për me e zhvendosë fatin tonë prej atje ku e ka çue inercia e shekujve, tue reshtë ma në fund së qeni prodhime pasive të një të kaluemeje të trishtueshme. Duket se At Zef Pllumit forca për me jetue e me shkruë i ka ardhë prej një imperativit të mbrendshëm: «Rrno vetëm për me tregue». Historia që ai na ka rrëfye ka qenë një premtim ndaj së vërtetës që nuk mujti me folë kurrë, një dëshmi ndaj së vërtetës që ia mbyllën gojën dhe e vranë, që ia sheshuen vorrin, ia dogjën veprat, që u munduen me e shue me damnatio memoriae.

Rrëfimi i At Zefit nis në fundin e vitit 1944. Asokohe nëpër rrugë parakalonin fitimtarët, tashma historia njihete vetëm zanin e tyre. Hapat e randë do të matnin aty e mbrapa deri edhe rreshtat e historianit në letër, çdo gja që do të shkruhej duhej t'i pëlqente atij hapi që shkelte kudo. As të vdekunit nuk i kishin shpëtue rrezikut. Mbas një lufte mes vedit shqiptarët



ishin nda në fituesa dhe në humbësa. Nji ish-teneqexhi dhe nji ish-student biokimie detyronin gjysmën e shqiptarëve me fjetë me tesha veshë, prej frikës se mund të arrestoheshin edhe në gjumë. At Zef Pllumi rrëfen jetën e njerzve të thjeshtë, t'atyne që qëndruen herë në heshtje e herë në ballë të stuhisë, në nji kohë që jeta e zakonshme ishte kthye në nji pantomimë të turpshme, të frikshme, të neveritshme. Edukimi normal ishte: me u ba spijuj para se me u ba njerëz. Deri edhe tufzimi i bagtivate u krye vetëm mbasi ishte krye tufzimi i njerzve. Ideologjija komuniste pikturonte së jashtmi shpirtin e shqiptarit me motive të hueja për të, dhe ndërkaq e zbrazte atë prej cilsinave të mira natyrale. Dhuna irracionale nuk kishte triumfue krejtsisht, kishte njerëz si At Zef Pllumi e dhunës i duhej të përballlej me forcën e arsyes.

Nën etiketën e komunizmit dolën në krye forcat ma të mbrapambetuna të shoqnisë, prodhimi shpirtnor i 500 vjetëve nënshtrim, përulje dhe verbnim vetëdijet kombtare.

Ata të cilëve nuk i kishte ardhë kurrë era njeri donin me ndërtue njeriun e Shqipninë e re!

Ndërkaq, intelektualët e vërtetë, shpirtnat e lirë e të ndritun, ata që ishin shpresa e Shqipnisë, prej Jugut në Veri, u pushkatuen dhe u burgosën si të ishin kriminela.

U shkyen teshat e reja për me arnue do zhele të vjetra 500-vjeçare.

Klioja, muza e historisë – u kthye prej historianëve të modelit enverian në nji prostitutë të shpartallueme, që në nji anë zbulonte huret e rreme e në anën tjetër mbulonte lebrën e vërtetë. Nuk duhet të harrojmë se e kaluemja komuniste ruen ende sot nji sovranitet të mshehtë mbrenda historiografisë shqiptare e flas jo vetëm për historinë e popullit shqiptar por edhe për historitë tjera të veçanta, tue nisë tek ajo e letërsisë, këtej e matanë kufinit tonë politik. At Zef Pllumi ka dashtë që jeta e tij të kthehej në nji mjet ase në nji rrugë për me njohtë deri në fund dhe për me tregue deri në fund të vërtetën.

Ai, shqiptarët i ka dashtë pse i ka njohtë. E ka



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**34**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

dashtë shqiptarin edhe mbasi e ka provue sesa i aftë asht shqiptari me i ba keq shqiptarit. E ka dashtë në një mënyrë që s'mund t'i mësohet kurrkujt, e ka dashtë me dashninë e Zotit. Ideali i një njeriu të arsyeshëm asht me njohtë dhe me tregue deri në fund të vërtetën. Por me njohtë dikënd deri në fund dhe me tregue diçka deri në fund asht e pamujtun. Vetë historia asht kufini i dukshëm i ekzistencës sonë toksore, pse ajo s'asht gjithçka.

Ka diçka që kalon përtej historisë. Ka diçka, që buron prej veprimeve tona të mira apo të këqija, që historia ia dorzon në fund amshimit si peng për lirim ose për dënimin tonë.

Vuejtja e pat mësue At Zef Pllumin se shpirti i njeriut nuk mund të njihet deri në fund e aq ma pak mund të përshkruhet deri në fund. Mbrenda secilit mbetë një mister i pathanshëm. Diçka e përgjumun, e trembun, e etun për dritë, diçka që ai vrojtoi sesi flente edhe mbrenda shpirtit të shumë kriminelave që njohti gjatë jetës së tij. Nganjisherë kjo gja misterioze mbërrinte me marrë trajtat e së mirës, por ma së shumti kthehej në një frikë të pakuptueshme, në një stepje përpara thirrjes së ndërgjegjes.

Kjo gja e ka shty At Zef Pllumin me qenë i vendosun kundër së keqes, por mos me e përbuz njeriun. Do të lodheni kot për me gjetë edhe një rresht të vetëm urrejtje a përbuzje në shkrimet e tija, pse ai ka pa tek njeriu krijesën e Zotit, edhe pse shpeshherë krijesa – tue mos pasë kurrfarë vetëdije - kambëngulte me u shpallë botnisht si mbasardhëse e majmunit.

Ai ka pa rreth tij, gjatë jetës plot vuejtje, marioneta pa shpirt dhe pa arsye, fijet e të cilave drejtoheshin prej larg e ndonjiherë edhe këputeshin përfundimisht tue ba që rolet të ndërroheshin e bota të përmbysesj papritun. Mjaft shpesh i qëlloi me pa sesi entuziazmi fanatik i kthente budallenjtë në qenje të pamëshirshme dhe të liga. Ne të gjithë e dijme se për me u ba atletë në një sport të caktuem kemi një kohë të kufizuese deri në një farë moshet, mandej humbë përgjithmonë mundsija. Ky asht kufizimi i qenjës sonë landore,

materiale. Por, për me e braktisë rrugën e marrisë së verbët s'asht kurrë vonë. E këtu qëndron siperania (superioriteti) e shpirtit të njeriut. Tek kjo veti njerzore ka besue At Zefi Pllumi, e për këtë arsye ai nuk ka dënue askënd, por ka paraqitë njerzit dhe faktet ashtu siç kanë qenë.

Për me rreshtue ngjarjet me besnikí, mjafton një kujtesë e fortë, e At Zefi e kishte këtë dhanti. Por, për me i kuptue ngjarjet duhet diçka ma shumë. Ka raste që edhe në jetën tonë, tue i dijtë faktet, e kuptojmë arsyen e gjanave vetëm mbas shumë kohësh. Për me ndjekë fillin dhe arsyen e ngjarjeve nevojitet vetëdija e shpirtit, gja që asokohe e kishte vetëm një pakicë njerzish. Ata që e kanë jetue historinë që rrëfen At Zef Pllumi, kanë përfutue në thellësinë e tyre një trishtim kur e kanë lexue.

Dikujt iu groposën andrrat në fund të vitit 1944 dhe jetoj me këtë trishtim deri në fund. Dikush tjetër pa fundin e idhujve dhe të utopisë në vitin 1990 dhe provoi trishtimin e zhgënjimit. E megjithatë, këto dy trishtime së bashku, thyemja dhe zhgënjimi, ende nuk kanë gjetë hapsinën e duhun në historinë tonë. Në 1991 u shemb një epokë me padrejtësinë, dhimbje, vuetje e askurrkush nuk i kërkoi të falun kurrkujt. Historia heshti turpshëm, pse atë ende e bajshin po të njejtit bakaj. Leximi i historisë edhe sot të len të shrejtun, pse të duket se tryeza e punës e historianit ka qenë një pasqyrë e mysët, ku e vërteta picigjatohet, ndërpritet, përthyehet, humbë dhe zhduket pa konture, pa ide e pa vijimsi. Kurse At Zef Pllumi lexohet me andje pa qenë historian, jo pse përfaqson një fenomen të izoluem për kohën kur ka jetue dhe as pse ka ba inventarin e dhimbjeve të një populli, por pse ka dijtë me e dallue para të tjerëve aurorën e një shprese.

Me thanë gjithçka për historinë, asht me thanë tepër, përsëriste dikur H. Taine, e At Zef Pllumi – e dijnë mirë miqtë e tij – nuk i ka thanë të gjitha. Ai asht ndalë tek thelbsorja, pse qëllimi i tij ka qenë jo me u kthye mbrapa e me numrue gjithçka, por me ec përpara tue u mundue me nxjerrë mësim prej



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**36**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

historisë. Tek At Zef Pllumi shkrimi i historisë nuk ka qenë një mënyrë me u skapullue prej së kaluemes. Ka qenë rruga për me çlirue shqiptarët prej peshës së padukshme të së kaluemes që jeton ende midis nesh dhe ndikon negativisht në jetën tonë. Antikiteti greko-romak na ka lanë trashigim idenë se kujtesa individuale dhe kolektive asht një art në vete. E ne sot o do të kultivojmë artin e kujtesës ose do të jemi të dënuem mos me e njohtë vetveten ma larg se dy breza, të dënuem me mbetë fëmijë e mos me u trajtue seriozisht prej kurrkuj, të dënuem me përsëritë të njejtat gabime, me mësue përditë të njejtin alfabet për me ba si fillestarë të njejtat gabime në keqshkronjën e historisë. Deri dje historia ishte një protezë trashamane e një realiteti të mjerë. E tashmja nuk ekzistonte ma, ajo ishte histori, ishte lavdi, ishte kult i padiskutueshëm. Sot kemi nevojë me jetue të tashmen të çliruem prej historisë, por me njohtë historinë pa u mundue me ia përshtatë së tashmes.

Friedrich Schiller-i tek një poezi me titullin Resignation, ndër të tjera shkruen: "Die Weltgeschichte ist das Weltgericht" (Sämtliche Gedichte, Insel, 1996, f. 159). Historia e një populli asht gjyqi i mbramë i atij populli, prandaj kemi nevojë për historianë që të kenë për ideal të vërtetën, dijen e papërlyeme prej interesave të tjera, ndershmëninë, paanësinë - pse prej historisë mvaret e ardhmja jonë, mbasi ne shqiptarët, ashtu si edhe ballkanasit e tjerë, hamë bukë e histori, e kur na mungon buka hamë vetëm histori.



Nga Dr. Dhurata SHEHRI



**AT ZEF  
PLLUMI**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**37**

## “AT ZEF PLLUMI – I FUNDMI I SHKOLLËS FRANÇESKANE”

**N**xënës në seminarin franceskan, ato ditë ashpra të viteve të sapovendosjes së terrorit komunist, më 1945-1946 Padër Zefit i caktohet detyra për të fshehur e ruajtur arkivin e Kuvendit Franceskan. Bashkë me të, i pavetëm atë kohë, ai merr mbi vete detyrën për të ruajtur trashëgiminë e madhë të franceskanëve shqiptarë, trashëgiminë e Françeskanëve të Mëdhaj, të cilëve do t’u vinte literalisht e metaforikisht “timbrin” me varrimin e eshtrave të mbetura të Fishtës e me veprën “Rrno për me tregue”. “...Si franceskan më mbeti mue me ia vue “timbrin”; ata të Mëdhajt ishin shue para gadi 50 vjetësh e un kishem teprue, nji nder bashkpuntorët e dikurshëm, ndoshta ai mâ I fundit...” - shkruan Padër Zefi.

Trashëgimtar, amantetqar, vazhdues, kujdestar, fatlum a fatkeq ai merr përsipër këtë detyrë gardiani, pa e ditur se kohët nuk qenë nga më të mirat për Shqipërinë dhe se tashmë do të mund të flitej për “një



**AT ZEF  
PLUMI**

**38**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

epokë komuniste” - po të shprehemi me fjalët e një prej martirëve franceskanë, At Ambroz Marlaskaj. “Nuk e di nëse ish fat ose fatkeqësi për mue, por po u tregoj se vorbllat historike të këtij shekulli më caktuen si amanetqarin, kujdestatrin e fundit të të gjitha veprave të tij të panumërta (Të At Gjeçovit) të ndryeme në një arkë drrese të veshun përjashta me pëlaster metalik e që ruhej me zili në arkivin e Kuvendit Franceskan në Shkodër. Un fatkeqi kur ia dorëzova atyne njerëzve, që po e shanin e po e përbuznin, më dukej se po dorëzojsha trupin e tij me e dhunue” - shprehet Padër Zefi ndërsa po pregatiste rivarrimin madhështor të eshtrave të mbetura të Fishtës. Misioni i tij shenjohej që fëmijë ndërsa frati franceskan do ta marrë me vete për në kuvend. Shenjën e amanetin letrar të franceskanëve të Mëdhej e merr mbi vete edhe kur shenjohej prej autografit të Fishtës pasi njihte përmendësh “Lahutën e Malcis”. Filli i vazhdimësisë së tij me Franceskanët e Mëdhaj është së pari intelektual. Si të gjithë të adhuruarit e vet, ai e identifikon veten me fatin e kombit, për fatin e keq të vet e të kombit do të duhej ta kryente misionin e ven në ditë nga më të errtat për kombin.

Etërve françeskanë, kultura shqipe u ka borxh më së pari kujtesën e vet. Mbledhja, ruajtja e asaj trashëgimie që përmblihet në “Kanunin e Lekë Dukagjinit” është fryt i At Shtjefën Gjeçovit. At Donat Kurti e At Bernardin Palaj do të mblidhnin prrallat, At Justin Rrota gjuhën e frazeologjinë geqe. Por misioni i Padër Zefit është më i vështirë. Ai merret me përrallën moderne të shekullit të njëzet të shqiptarëve, me dëshminë e barbarisë komuniste. Detyra që më vështirë se ajo e pararendësve të tij të Mëdhenj. Kësaj here nuk ishte në lojë vetëm arkiva e lashtë e Kuvendit Franceskan. Ishte në lojë vetë fara shqiptare. Nëse pararendësit e tij të Mëdhaj ia dolën të ruajnë kujtesën e kombit, Padër Zefi duhet ta mbronte kombin nga harresa. Që të mos përsëritej më ajo që kish ndodhur duhej treguar, duhej dëshmuar, duhej përjashtësuar, si të gjitha të këqijat e mëdha. Pinjollit i Françeskanëve të Mëdhenj, ndryshe nga mjeshtrit e tij të, tregoi cka më të keqe një komb, atë pjesë aq të errët që nëse nu k tregohet mund të përsëritet sërish. Në fakt, harresa e shqiptarëve ishte e

shumëfishtë. Shqiptarët kishin harruar zanafillën dhe rrugëtimin e etërve për t'u gjendur një ditë me etër të rinj, internacionalë, që asgjë nuk kishin të përbashkët me to. Prandaj, misionarit për atme e fe iu desh t'i rinxirrte nga "arkat e drrasave" që i kishin lënë në ruajtje ata vetë, franceskanët e mëdhej.

Lind kështu projekti i madh i botimeve françeskane dhe rinis botimin "Hylli i Dritës".

Duke rinxjerrë në dritë veprat e mësueve të tij të ndritur, shërbimi është i dyfishtë: bota shqiptare pasi kish kaluar nëpër hierarkitë ideologjike të komunizmit duhej t'i përmbyste ato përmes njohjes së traditës së vet, e franceskanët ishin pjesë e kësaj tradite. Duke u njohur me veprën e tyre shqiptarët hapin një tjetër derë, atë të origjinës, të zanafillave, për të kuptuar, ata që duan të kuptojnë, se murtaja komuniste që vec një njollë e re, një shtresë krejt e hollë në trungun shqiptar.

Një tjetër përmasë ruhet e të vazhdon me veprën e padër Zefit, gegërishtja letrare. Lexuesit e sotëm kam fatin të njohin në veprën e tij fillin e këputur të lërtsisë gege të ndërprerë përdhunshëm me moskomunikim të autorëve dhe veprave të ndaluara për 50 vjet. Gegërishtja letrare rimerr statusin e një gjuhe letërsie që vazhdon të shkruhet, që nuk është vec pjesë e historisë, por që historinë e dëshmon, e krijon. Gjithçka në veprën e Padër Zefit operon me kategori të ndaluara. Ai shkruan gegnisht, kur ajo kish më shumë se 30 vjet që qe shpallur "e paligjshme", ai shkruan si shkrimtar franceskan, kur kish më shumë se 50 vjet që komunikimi me autorët më të dhej të kësaj letërsie që ndërprerë dhunshëm, ai shkruan për atë që kish ndodhur në burgjet komuniste atëherë kur dukej se historiografia zyrtare e kish mbyllur kapitullin e kujtesës me harresë.

Ashtu sic zhduku cdo gjurmë të së shkuarës, diktatura komuniste deshi të zhdukte cdo gjurmë të kulturës shqiptare të krijuar nga franceskanët. Në projektin e regjimit komunist zhdukja e veprës së autorëve franceskanë shkonte paralelisht me zhdukjen e tyre fizike në burgjet komuniste. Dëshmia e Padër Zefit është provë jo vetëm e faktit që kjo kulturë mbijetoji, por edhe dëshmi e barbarisë së kulturës së dhunës të ngritur në sistem nga regjimi komunist.



**AT ZEF  
P L L U M I**



AT ZEF  
PLLUMI

40

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



Nga Dr. Ardian MARASHI

## TESTAMENTI KULTUROR I FRANÇESKANËVE TË MËDHENJ

**I**shte një kohë kur stërgjyshët tanë mbretër e princa, dembelë gjuhësorë si shumica e Europës së moçme, paguanin shkruer për të hartuar akte e dokumenta në gjuhët e fqinjve helenë e latinë. Një prift, atëbotë, mbas gjasash françeskan, u sflit në ecejake mes kishës e shtypshkronjës; rrëfen Buzuku: "...unë nuk mund të isha përherë pranë tyre [shtampuesve], ngase mbaja kishën e më duhej të shërbeja në të dy anët". Qëllimi i Buzukut për të nxjerrë në shqipe një libër që do t'u përcillte vendasve fjalën e Hyjit në gjuhën e tyre, u përcoll nëpër këtë gjuhë e ndër breznitë e klerikëve vendas, për të mbërritë i pabjerrë deri te dishepulli i mbramë françeskan në linjë të pakëputur, At Zef Pllumi. I vetmi privilegj që prifti i moçëm Buzuku kërkoi për këtë shërbim, ishte: "Nëse ka qenë e thënë të kem bërë ndonjë gabim në ndonjë vend, dhe ai gabim bie në sy, i lutem atij që mund të jetë më i ditur se unë që atë gabim ta trajtojë me zemërgjerësi.



Se nuk çuditem po të kem gabuar, meqenëse kjo është e para vepër dhe fort e vështirë për t'u kthyer në gjuhën tonë." I vetmi shërbim që prifti ynë Pllumi na e kërkoi si privilegj është që të mos gabojmë për herë të dytë, duke dënuar me harresë ata që i patëm dënuar me burg, por të merremi seriozisht me zbulimin dhe me rizbulimin e vlerave të mirëfillta kulturore e qytetëruese, shumë prej të cilave u krijuan në gjirin e kuvendeve françeskane nga punëtorë të sprovuar në devotshmëri dhe në profesionalizëm, një prej të cilëve ishte vetë At Zef Pllumi.

Në parathënien e veprës "Fransëskanët e mëdhaj", botuar më 2001, teksa bën bilancin e kontributit françeskan në kulturën kombëtare të 'shekullit të pamvarësisë', At Zef Pllumit, njeriut që ishte më i vetëdijshëm e më i trishtuar se të gjithë ne për ndërprerjen brutale të traditës françeskane, por edhe më i fthylluari e më seriozi për të vlerësuar rëndësinë e kësaj tradite, i mbeti thjesht të konstatojë: "Kuvendi Françeskan *do të mbetet* një fenomen i papërsëritshëm në historinë e kulturës shqiptare." Shkapërcimi kohor nga e shkuara tek e ardhmja, pa kaluar nëpër detyrimin e natyrshëm të së tashmes, e përcjell gjithë dhimbjen që shkaktoi këputja mu në lulëzimin e saj e një tradite e cila me të vërtetë *mbetet*, në aspektin e së *tashmes eterne*, një dukuri e papërsëritshme në historinë e kulturës shqiptare.

Ne brezat e sapodalë nga paranoja e kulturës masovike të barazitizmit të vlerave nga poshtë, aspironim të përthithnim limfën e gjallë përtritëse të vlerave të epërme, të cilat u pa se nuk i kishin munguar kurrë këtij vendi, përderisa, ndër ne më të rinjtë, që ishim brezi i destinuar për t'i shërbyer eksperimentit të shpëlarjes së kujtesës, aspirata për të ringritur vlerat e konfirmuara të kulturës kombëtare kishte mbijetuar me këmbëngulje. Padër Zefi, siç e thërrisnin shkodranët dhe miqtë, u bë për ne të gjithë, për pesëmbëdhjetë vjet, figura ku kjo aspiratë mundi të trupëzohej, për t'u shndërruar në vullnet pune. Sidoqoftë, me gjithë këtë vullnet tonin, do të ishte pothuaj e pamundur që rrënoja kulturore të ringrihej pa deformime kërcitëse të strukturës, nëse figura e priftit energjik nuk do të ishte mes nesh për të na nxitur e orinetuar, sipas parimit "n



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLUMI**

**42**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

së dashunit botës sanë”, që ai e vetë e trashëgoi në vijë të drejtpërdrejtë. Pa ndihmesën e këtij trashëgimtari autentik të Kuvendit Françeskan, ne aspirantët e kulturës shqiptare të fillimviteve nëntëdhjetë do të ishim ndjerë dyfish jetimë në misionin që na priste: ringritjen e ngrehinës.

Me “Franceskanët e mëdhaj” Padër Zefi na tregoi se cilët qenë trarët e kësaj ngrehine dhe cilët gurët e rëndë. Foli për *shpirtin* e franceskanëve shqiptarë – At Gjergj Fishtën – poet kombëtar, si dhe për “dymbëdhjetë apostujt” që iu bënë krah deri në martirizim: At Shtjefën Gjeçovi – themel i etnologjisë dhe i arkeologjisë shqiptare, At Pal Dodaj – arkivist, gardian i thesarit dhe ‘diplomat i paemnuem’, At Ambroz Marlaskaj – profesor i jurisprudencës dhe edukator, At Vinçens Prennushi – poet, përkthyes dhe didakt, At Marin Sirdani – mediasvist i palodhur, At Anton Harapi – filozof dhe moralist, At Justin Rrota – latinist i thekur e gjuhëtar i ftilluar, At Marti Gjoka – drejtues artisk dhe themelues i shkollës muzikore shkodrane, At Bernardin Palaj – babai i etnofolklorit, At Donat Kurti – etnolog dhe përkthyes, At Benedikt Dema – autor i të parës Enciklopedi shqiptare, At Gjon Shllaku – poliedrik i superdiplomuar. Dhe besoi se ne do ta plotësonim vullnetin e tij për të folur e shkruar edhe për Fra Pal Hasin – poet bashkëpunëtor i Budit, At Françesko da Leçen – gramatikan, At Leonardo de Martinon – arbëreshi i madh, At Pashko Bardhin – publicist i palodhur, At Viktor Volajn – gjuhëtar erudit, dhe At Daniel Gjeçajn – biograf, kritik e përkthyes. Dhe e përfundoi padër Zefi shkrimin e vet mbi franceskanët e mëdhenj siç nuk e kishte zakon, duke i dhënë formën e testamentit e duke na bërë thirrje: “Kam shpresë të më plotësohet ky *testament*.”

Teksa na vuri përpara detyrimit të dyfishtë moral e kulturor për të hulumtuar rreth atyre që “formuen lëvizjen ma të fuqishme kulturore mbas Pamvarësisë”, padër Zefi dëshmoi se e dinte vlerën e testamentit. Si gjithmonë, edhe me këtë testament të tij ai u kujdes për të mirën tonë, më fort sesa për veten. Ai qe i vetëdijshëm se ribotimi i veprave dhe botimi e studimi i dorëshkrimeve franceskane do të na hapë një ndër portat

e rënda të kulturës kombëtare, e cila mban të kyçura prodhimin e plot një shekulli përpjekjesh kolektive *sistematike* në lëmë të dijes, të kulturës dhe të letrave shqipe. Nëse mbetemi vetëm te gjuhësia dhe leksikologjia, një seri veprash themelore imponohen vetvetiu për studim, të tilla si: *Gramatika e gjuhës shqipe dhe Plotësime në Fjalorin e Bashkimit të At Pashk Bardhit, Rreth gramatologjisë shqipe dhe Për historinë e alfabetit shqip* të At Justin Rrotës, *Fjalori i fjalëve të rralla dhe Fjalori toponomastik* të Dom Nikollë Gazullit, apo *Fjalori Enciklopedik* disavëllimësh i At Benedikt Demës. Nëse vazhdojmë më tej, zbulojmë punën voluminoze të Gjeçovit, Palajt, Kurtit, të cilët na sjellin fjalën autentike të popullit, timbrin e rapsodit, vullnetin e ligjvënësit anonim, magjinë e mitologjisë shqiptare të pabjerrë ndër shekuj. Nëse hidhemi përtej, do ta shohim veten këmbë e krye të zhytur në thellësinë studimore të veprave të veçanta, po aq sa edhe të problematikës – gjithnjë aktuale – të *Hyllit të Dritës*. Përtej këtyre, *udhëtimi* na çon mu në portat e Parajsës letrare, për të klauar momente përjetësie në shoqërinë energjike të *Lahutës* fishtiane.

Në këtë pikë mrekullimi, testamenti kulturor i Françeskanëve të Mëdhenj shpalohej para nesh në tërë kuptimësinë e tij: “Është shpirti i njerëzve që e bën vendin; është kultura që e bën shpirtin e njerëzve.” Detyra jonë, në kontekstin aktual, është që të rehabilitojmë *sasinë* dhe *cilësinë* e prodhimit kulturor të breznive françeskane, të përfitojmë nga realizimet e tyre dhe t’i vëmë këto realizime, me funksion të plotë, në shërbim të kulturës shqiptare.

Një përgjegjësi të këtillë po bëhet gati ta marrë përsipër Qendra e Studimeve Albanologjike, institucioni i ri kombëtar kërkimor-shkencor në fushën e studimeve shqiptare. Padër Zefi, që ishte më tepër se kritik kundrejt ish-Akademisë, do ta mirëpriste me besim ndryshimin.

“Çka na mungon ne që mos të jemi si evropjanët tjerë, – pyeste padër Zefi. – Toka, jo; dielli e deti, jo... na mungojnë vullneti e trimnia për me thanë të vërtetën... Na mungon mendja e mentaliteti e, mbi të gjitha, dashunia.

Sot, me këtë tubim, ne po dëshmojmë se *dashunia* ka gjasë të zbresë mes nesh.



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**44**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



Nga Kate SCHANK

## LIVE TO TELL – “RRNO VETËM PËR ME TREGUE” E ATË ZEF PLLUMIT NË AMERIKË

**P**ërkthimi anglisht i veprës “Rrno vetëm për me tregue” i Atë Zef Pllumit po bahet i gjindshëm për shumë lexues, e gjithnji e më tepër i njohtun e ma i përhapun në Shtetet e Bashkueme të Amerikës. Kam punue për botimin e vëllimit të parë në anglisht e tash po merrem me promovimin e tij. Jam e gëzue me që më respektojnë për këtë punë e ndjehem e nderueme që kam pasë ndihmesën e disa personave të çmuem, të pranishëm apo jo këtu, po përmendi Petro Zhejin. E megjithëse miku ynë i shtrenjtë e mentori Atë Zefi, nuk asht këtu personalisht, e ndjejmë se shpirti i tij i madh asht me ne sot e po bahet dita me ditë ma i pranishëm edhe në Amerikë.

Atë Zef Pllumi, si autor ka lanë një shenjë të vetën tue shkruar vëllimet e “Rrno vetëm për me tregue”. Ajo çka ai ka shkruar asht tronditëse jo vetëm për atë si person,— një shtyllë e Kishës Katolike në Shqipëri, —

por edhe se këto libra janë simbole të antikomunizmit. Asht me shumë randësi që historinë e tij ta dëgjojnë sa ma shumë lexues të jetë e mundun që të ndërgjegjësohen e të bahen të vetëdijshëm për atë çka tashma asht e shenjueme në analet e historisë botnore.

Tashti kjo vepër e çmueshme mund të gjendet edhe në SHBA, e për një kohë të gjatë e vërteta e përshkrueme aty ka me u përhapë gjithnjë e ma tepër e gjithnji e ma shumë persona kanë me u ndërgjegjësue për të.

Përkthimi i vëllimit të parë asht botue nëpërmjet shtëpisë botuese iUniverse dhe po shitet online. Po ashtu libri gjindet edhe ndër disa prej librarive ma të mëdha në SHBA sot, si përshembull Amazon.com, apo Barnes e Noble, tue e kthye veprën e Atë Zefit në një sukses gjithmonë e ma të madh. Synimi jem asht që vepra të njihet për atë çka asht, jo vetëm sepse kjo asht ajo çka Atë Zefi do të kishte dashtë, por edhe pse asht e randësishme për historinë. Edhe përkthimi i vëllimit të dytë po ashtu ka me përfundue së shpejti. Asht me randësi që Shtetet e Bashkueme të Amerikës të fillojnë me njohtë Shqipninë e që ky vend të mos fshihet ma nën velin e një misteri e që historia e tij e vërtetë të mos fshihet.

Shpresoj se, ndërsa lexuesit e librit "Rrno vetëm për me tregue" shtohen, ne kemi me u ba të afërm si të ishim miq të mirë, të cilët nuk kanë qenë në gjendje me komunikue me njeni-tjetrin derisa Demokracia erdhi në Shqipni.

Historia e Patër Zefit u jep amerikanëve një kandvështrim të brendshëm, të parrëfyem ma parë si perspektivë. Nuk asht një autobiografi e zakonshme, por një kandvështrim unik i kallzimeve në vetën e parë të një meshtari e të përvojave të tija dhe historia e asaj çka ai dëshmon. Asht një dëshmitar i besueshëm për të cilin kemi simpati, mbasi ai nuk na përçon vetëm atë që din mbi ngjarjet, njerzit e vendet, por edhe urtinë e besimit të tij si edhe filozofinë e tij personale. Nji njeri i mbajtur në burg e që kaloi shumë tortura ma në fund çon zanin e flet. Këto janë britmat e tija të cilat ma parë nuk kemi mundun t'i dëgjojmë sepse ia kishin zanë në fyt derisa ai fitoi lirinë e nuk ishte ma në rrezik.



**AT ZEFI  
PLUMI**

\* \* \*



**AT ZEF  
PLLUMI**

**46**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

Pse ky libër ka një domethanie kaq të madhe për ne amerikanët, që ndoshta ma parë as nuk e kanë dëgjuar emrin e tij e pse kemi simpati për këtë hero?

Shumëkush në Shtetet e Bashkueme mundet edhe që të mos ketë dëgjuar kurrë për ekzistencën e një vendi kaq të largët që quhet Shqipëri, ose ndoshta deri para luftës në Kosovë dhe ndërhyrjes së Klintonit. Ose ndoshta shumë prej amerikanëve mundën me pasë paragjykimet sesi janë shqiptarët, apo pse kanë jetuar nën komunizëm për kaq shumë vjet e çka kanë kaluar. Tashmë këta persona janë të interesuar me nxënë ma tepër mbi Shqipërinë e mbase Luftës së Dytë Botërore e si që në të vërtetë jeta e shqiptarëve nën regjimin e porsavendosur komunist. Me të vërtetë që duem me e njohë historinë e Atë Zef Pllumit si edhe çka e bëri atë e të tjerët si ai të denjë për mirënjohje. Kjo është historia e tij por edhe e historisë, e ne gjendemi në anën e drejtësisë.

Atë Zef Pllumi ka shumë vëllazër e motra amerikanë, qofshin këta fetarë apo jo.

Vuejti sikurse të gjithë të tjerët në ato kushte. Që një prej viktimave të shumta të atij sistemi të korruptuar. Çdo njeri i aftë o i pa aftë mendërisht do të ishte në anën e tij, pavarësisht bindjeve politike, fetare apo kombësisë që mund të ketë. Zani i tij na bret sot me të madhe të vërtetën. Na shtjën ndërmend ngjarjet ndërsa na i shohim të shpalosen dora-dorës. Dëgjojmë të na flasin ato faqe të testamentit të tij ku përshkruhen padrejtësitë, tmerri, krimet e vujtjet ndërsa shkrimtari na shfaqë pamje të ngjarjeve të vërteta të cilat ne as nuk do t'i kishim menduar. Në të njëjtën kohë ky libër është një histori vëllaznime, e moralit të naltë, e besimit, e përkushtimit, e misionit si edhe e nderit të një njeriu. Ai është një nga herojtë e shumtë të luftës që kryen detyrën e vet.

Ne amerikanët e vendosim veten tonë në këtë histori dhe e identifikojmë vetveten me heroin, Atë Zefin. Ai na shpjegon sesi që e mundun që ai mbijetoi: kishte qenë i armatosur me besimin e tij te Zotit, tue e dijtë se ai dhe kolegët e tij u përpoqën vetëm me rrejtë dhe me përmirësuar kulturën e Shqipërisë, historinë e dokumentet

historike, besimin fetar e letërsinë.

Njeriu dhe veprat e tija. A ka ndonji gja të re për nën këtë diell? Ndoshta ky libër ka me ndryshue diçka në kandvështrimin tonë.

Ky asht një dokumentim historik i historisë së sotme, me randësi për të gjithë botën. Asht një dëshmi e çmueshme sepse ai asht i vetmi që mundet me na dhanë kandvështrimin e tij të veçantë. Mendoni pak për të gjitha ato dokumente historike të shkatërrueme për të cilat flitet në fillim të librit. Ky libër ka një vlerë të madhe sepse përmes syve të Atë Zefit, ma në fund shohim imtësisht atë çka ndodhi. Vetëm ai do të kishte qenë në gjendje me e ba këtë tue na përcjellë emna, vende e ngjarje. Ai na jep një mësim të përbotshëm, dhe mësimi asht gjithmonë i ri dhe mundet me ndikue tek ndryshimet.

Ajo çka mësojmë asht se cilat qenë përpjekjet me ruejt lirinë fetare në Shqipni mbas luftës. Kleri si grup luftoi me e ruejt Katolicizmin në Shqipni si edhe me mbajtë organizimin dhe mos me e bjerrë besimin përballë egërsive dhe persekutimit të paimagjinueshëm.

Në nxajmë prej këtyne historive të tmerrshme — ma parë të parrëfyeme — që duen me i fshi prej kujtesës së njerëzve e me i lanë jashtë dokumenteve. Pse ndodh kjo gja, kur në kombin tonë, nën Zotin, kjo harresë nuk duket se ndodhi mbas luftës.

Amerika aso kohe ishte rranjësisht e ndryshme prej si ishte Shqipnia mbas luftës. Robët e luftës e ushtarët që ktheheshin nderoheshin, historitë e tyne u kallzoshin dhe të gjithë i dëgjojshin në një kohë kur jeta vazhdonte. Ndoshta kjo asht një prej historive të para në llojin e vet që kallëzon hollësisht e me saktësi se çka donte me thanë me qenë i burgosun në Shqipni mbas Luftës së Dytë Botnore. Përshkruhet diktatura në kohë e në vend si edhe cilat qenë politikat që çuen në vendosjen e demokracisë në Shqipni.

Po problemi i Kosovës që çoi deri në luftën atje?

Nuk kishim dëgjue ma parë të flitshin për Shqipninë sepse informacionet e këtij lloji nuk të dilshin kurrë prej vendit, e nuk ishte e lejueme as me folë apo me përmendë se ç'jetë bajshin njerëzit në Amerikë – një



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**48**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

vend ku ne, tue jetue në demokraci, nuk e dijsim se çka po kalojshin shqiptarët. Ne nuk e dijmë se çka don me thanë me jetue nën një diktaturë komuniste, ku frika, padrejtësia, çnjerëzia dhe krimi i verbët sunduen për një kohë shumë të gjatë.

Nuk e kemi marrë ne vesh historinë e shqiptarëve, apo të persekutimit fetar atje dhe a nuk jemi ne të ndërgjegjshëm për herojtë dhe martirët të përshkruem në libër? Ky dokumentim i vërtetë i ngjarjeve si edhe i atyne që kryen këto krime të parrëfyeshme që përshkruen e jepen me emna në këtë libër, janë me një vlerë që i kapërcen kufijtë e një shteti të vogël.

Së shpejti historia e Atë Zef Pllumit ka me qenë e mirënjohun dhe e përhapun në të gjitha Shtetet e Bashkueme ndërsa përkthimi në anglisht po fiton popullaritet.





Nga Rudolf MARKU

## AT ZEF PLLUMI, MES DIJES, EVIDENCËS HISTORIKE DHE GJUHËS

**K**ur At Zef Pllumi e pat titulluar njërin ndër librat e vet "Histori kurrë e shkrueme", atij me siguri nuk i pat shku ndër mend se me këtë titull, ai ishte duke u përfshirë në debatin e madh se si shkruhet Historia, ose, e thënë ndryshe, përngjashëm me titullin e veprës së vet, se si nuk duhet shkruar Historia. Një debat ky jo shqiptar, par botnor, që vazhdon të zhvillohet sot e kësaj dite me botime librash nga autorët me autoritarë të fushës së Historiografisë"...

Debati më i madh i shikimit të Historisë, si një ndërtim narrativ i bërë nga historianët, është nëse vlerësimi i fakteve dhe ngjarjeve dhe reflektimi mbi to i historianit është objektiv, jo i deformuem, par i bere si nje ushtrim ne përputhje me shpirtin e kërkimit të së vërtetës. Arthur Marwick, në librin "Natyra e re e Historisë" shkruan se Historiani përcaktohet në një trekansh me brinjët "Dije, Evidencë dhe Gjuhë". Dije,



**AT ZEF  
PLLUMI**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**49**



**AT ZEF  
PLUMI**

**50**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

sepse historiani “nuk e ndërton të shkuarën dhe as nuk e prezanton të shkuarën” - ashtu siç besohet në mënyrë të gabuar. Historiani prodhon dijen e vet rreth të shkuarës. Arthur Marwick ashtë kundër teorisë së autorit (*Auteur theory* asht zakonisht përkthimi në anglisht i “La politique des auteurs” në frëngjisht, frazë e përdorur për herë të parë nga kineastët francezë të Valës së Re.) Nëse do të prananim teorinë e Autorit, do të prananim në mënyrë të pashmangëshme dhe relativizmin në histori, çka do të thoshte as më shumë e as më pak se të prananim idenë se pozita e historianit asht në vartësi të qendrimit dhe hanes subjektive të historianit si individ. Këtë tezë e kanë mbështet tre autoritetet e cituar më së shumti në epistomologjinë historike, Collingwood, Carr dhe Peter Novick. Ndërsa dy të parët janë tepër të njohur për të sqaruar se kush janë, të paktën në historiografinë anglo-saksone, Peter Norwick ka tërheq vëmendjen me veprën e vet të botuar në vitin 1988 “Çështja e objektivitetit dhe profesioni amerikan i historianit”. R.C.Collingwood shihet i ndikuar së tepërmi prej italianit Benedetto Croce, e prej këtu asht e kuptueshme përse libri i tij na çon në botën e metafizikës dhe përse në librin e tij aplikohen në mënyrë të pavend termat filozofike që nuk i shkojnë historisë. Sepse historianët nuk janë as Idealistë dhe as Materialistë. Historianët janë thjeshtë historianë. Collinwood adapton njëren nga thaniet e njohura të Crates “E gjithë Historia asht një histori bashkohore”. Nuk asht e vështirë të shihet se as Collingwood dhe as Croce nuk bajnë dallimin mes asaj që asht Histori dhe asaj që asht e Shkuar, Collingwood, ashtu si të gjithë tradicionalistët e historiografisë letrare, madje ashtu si dhe vetë Idhulli i vet, Croce, beson se historiani asht një autor, se Historia del e formuar perfektësisht nga mendja e historianit, duke injoruar kësisoj se Historia asht një ndërmarrje bashkëpunimi marrjesh dhe dhanjesh. Në shkrimin e Historisë nuk ka Rembrandts, nuk ka Shak’espeares dhe nuk ka Beethoven. Historianët bien dakort a nuk bien dakort me njani-tjetrin, grinden, kundërshtojnë njani-tjetrin, kundërshtojnë vetveten, ndryshojnë dhe ripërcaktojnë pamjet e veta. Vepra e

historianit asht në ri-shikim të vazhdueshëm, ajo modifikohet, përmirsohet, ri-shkruhet. Ne nuk do guxonim që të ri-pikturonim pikturat e Rembrandtit apo ta ri-shkruanim muzikën e Beethoven-it. Por, nga ana tjetër, Historia shkruhet dhe rishkruhet. Vetëm një mendje e një ndryshkësie kokfortë do të kishte guximin për të mos pranuar ri-shikimin dhe ri-shkrimin e historisë. Ndërsa një autor tjetër, E H Carr, të cilin siç e përcakton vetë Arthur Marwick "të qenunit jo marksist, por stalinist", nuk e ka penguar që të mbajë karriken e kryelektorit të historisë në Cambrdige, në leksionet me titull "Çfarë asht Historia?" që ka mbajtur në vitet e hershme të dhjetvjetorit '60', thotë se: "Historia asht një dialog që nuk mbaron (an un-ending dialog) mes së shkuarës dhe së tashmes". Ajo çfarë thotë Carr asht thjesht një ri-marrje e tezës së Collingwood (dhe e shumë të tjerëve) se "Çdo epoke shkruan historinë e vet", se "çdo epokë duhet ta ri-interpretojë të shkuarën në dritën e preokopimeve të veta", Metafora dhe antropomorfoza (the metaphor and the anthropomorphosis) këtu janë të ekzagjeruara. Jo se thaniet nuk kanë bazë, por se nuk janë të mjaftueshme për të vërtetuar se historia asht në mënyrë të pashmangëshme subjektive. Ma e vërtetë se Historia asht dialog mes së shkuarës dhe të tashmes, do që se Historia asht një dialog i pandërprerë mes historianit dhe lexuesit të vet, në kuptimin e përpjekjeve që të dy palët janë të përgaditur për ta bërë këtë dialog.

2. Brinja e dytë e trekandëshit të historianit i përcaktuar sipas Arthur Marwick asht Evidenca apo dokumentacioni, fakti, kronika. Këtu dhe historiani si historian dhe historiani si jo historian janë të ndarë me një Mur Berlino. Në anën e Berlinit Lindor janë të gjithë ata historianë që besojnë se evidenca, dokumentacioni, fakti janë të rëndësishëm së dorës së dytë dhe se Historia mund të shkruhet pa evidencën e shkruar, pa dokumentacionin, pa arkivin dhe faktin. Le ta themi që në fillim se ata që e kundërshtojnë me forcë evidencën, faktin, arkivin, kronikën, si të dorës së parë në shkrimin e historisë, ata që flasin me përbuzje për "fetishizimin e dokumentave dhe për kultin e arkivit"



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**52**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

janë historianët marksistë dhe ata marksizianë, këta të dytët të ndikuar shqitazi nga marksizmi: italiani Antonio Gramsci, Gjermano-Amerikani Herbert Markuse, Hyaden White, dhe frëngj post-strukturalistët Michel Foucault, Roland Barthes, Loius Althusser dhe Jacques Derrida, si dhe postmodernistët Jean-François Lyotard dhe Jean Baudrillard. Duke qenë marksistë, asht krejt e natyrshme që të mendojnë dhe të argumentojnë se evidenca, fakti, dokumentacioni i dorës së parë nuk janë të rëndësishme për Historinë. Në momentin që ke argumentuar se dokumenti nuk është i rëndësishëm për historinë, e ke shumë të lehtë manipulimin e saj. *Foucault* dhe *Barthe*, p.sh. kanë mbajt një qendrim kritik ndaj historianëve profesionist, gjë që mund të shihet qartë në esenë e Bartit "Diskurs për Historinë", ku Historia deklarohet as më shumë e as më pak se një ideologji borgjeze.

Historianët e anës përtej Murit të Berlinit mendojnë tjetërsoj. Leopld von Ranke qysh në vitin 1880 shkruan në veprën e vet "Historia Universale": Historiani punon me dokumenta. Dokumentat janë gjurmët e mendimeve dhe veprimeve të njerëzve të kohave të tjera. Atje ku s'ka dokumenta, nuk ka histori". Historianët francezë Charles Langlois dhe Charles Siegnobos në "Hyrje në studimin e Historisë - botuar së pari në anglisht në vitin 1898, shkruajnë se "Asnjë histori e një vendi të veçantë nuk mund të shkruhet nëse populli i atij vendi nuk ka lënë ca rregjistrime dhe gjurmë të veprimeve të veta". "Kafshët jetojnë në mënyrë jo-historike" - pat thënë F.Nietzsche tek sodiste në mënyrën me prozaike lopët tek kullosnin në një livadh alpin (F.Nietzsche -The use and the abuse of History, përkthyer nga Adrian Collins, Indianaplose, 1951). Në kundërvënje të papajatushme, madje agresive, me tezen e nevojës së dokumentave të shkruar, asht historiani i sotëm amerikan Daniel Lord Sniail, profesor i Historisë në Universitetin e Harvardit. Në librin e tij të titulluar "On deep history and the brain" botim i vitit 2008, një libër që është përshëndetur në mënyrë entuzisate nga shumëkush, autori shkruan rreth 300 faqe për të provuar e stërprovuar në mënyrë der në bezdisje se" Dokumentat e shkruar nuk janë thelbësore

në shkrimin e Historisë" (Written documents are not essential to the writing of History). Asht një ndër librat ma të fundit të botuar për Historinë në gjuhën angleze.

3. Historia asht procesi i kalimit të fakteve dhe ngjarjeve të së kaluarës në atë narracion a brryl a kthesë narrative-linguistike që thirret Histori. Teoritë postmoderniste të gjuhës nënkuptojnë se çdo akt gjuhësor jep kuptime që i tejkalojnë qëllimet e autorit; se çdo tekst krijon shumësi kuptimesh, dhe se këto kuptime shpesh mund të kundërshtojnë njëri-tjetrin dhe se interpretimi i tekstit na bën të mundur kuptimin e njëmend a original, ngase asht vete një pjesë e lojës së kuptueshmërisë që prodhon teksti, e kshtu me rradhë. Një komplikim aq i madh, sa nuk është e rastit se me fillimin e shekullit XXI. Historianët po e vënë theksin përherë e me tepër te analiza e ngjarjeve, në dallim nga Strukturat kuptimore dhe Rrjetat kuptimore (Shih Profesor Yes-Marie Barce, numri Mars/Prill 1999 i Histori, Shkenca Shoqnore). Por nëse pranojmë, bashkë me postmodernistët, rëndësinë e jashtëzakonshme të gjuhës, në kundërshtim me ata naive që e shohin gjuhën si një medium të thjeshtë, të pakomplicuar të komunikimit, duhet thanë se metoda historikë i ka rrënjët e veta prej shekujsh në filologji dhe se çështjet e semantikës dhe të domethanjës kanë preokupuar gjenerata historianësh, shumë shekuj përpara poststrukturalisëve. Dhe, kur është puna te librat e Historisë, apo te shkrimi i Historisë, të gjithë bien në një mendje me Voltaire-n që e kish zakon të thoshte se metaforat për Historinë jane si krymbat që gërryejnë librat, se Historianët e mirë gjithmonë e shmangin ambiguitetin; se frazat duhet të jenë të qarta, e mendimet e kthjella...

4. Megjithë origjinalitetin që ka Shqipnia, keqkuptimet e historiografisë shqiptare janë një refleks-edhe pse i deformuem deri në karakature, në atë mënyrën karakteristike shqiptare- i keqkuptimit dhe konfuzionit që ka ekzistuar në historiografinë botnore sidomos gjatë shekullit të XX. Dhe ky konfuzion ka bërë që Edouard Herriot, kryeministër francez, kur pat vizituar Ukrainën në kohën e urisë së madhe, pat takuar vetëm fëmijë që



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**54**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

qeshnin e që i thoshin atij se hanin pite me mish çdo ditë. Kryeministri francez kërkoi të vizitonte një kishë. Sigurimi i shtetit brenda një kohe të shkurtër e ktheu përsëri në kishë magazinën e grurit, e cila kishte qenë kishë dhe vete sigurimsat veshën rroba fshatarësh të mirëqenun dhe filluan të shtiren sikur po luteshin, ndërsa komandanti i tyre ngjiti një mjekër prifti nga rekuizita e shtëpisë së kulturës dhe filloi të predikonte...

Herriot nuk arriti të kuptonte asgjë nga ky mashtrim, ngase që i interesuar që të mos kuptonte gjësendi, dhe shkroi me entuziasëm për Historinë e shkëlqyer të sistemit sovjetik. Romain Roland, romancieri francez, që shoqëruar në një nga burgjet politike nga kriminelin famëkeq Yagoda, shërri i policisë politike në kohën e Stalinit, i cili e siguroi romancierin francez se riedukimi i të burgosurve qe një eksperiment i përsosur pedagogjik, nga i cili mund të përfitohej njeriu i ri. Dhe Romain Roland qe tepër i kënaqur nga ky sistem burgjesh edukative. George Bernard Shaw gjithashtu ka vizituar kampet e të burgosurve në Rusi dhe ka shkruar për sistemin e mrekullueshëm të tyre. GjatëLuftë sëDytëBotnore, zëvendëspresidenti amerikan, Henry Agard Wallace, ka vizituar gjithashtu një kamp skilleverish të punës korrektuese dhe ka shprehur entuziazmin më të madh për sistemin magjepsës sovjetik...(Wallace and Steiger, Soviet Asia ...Në mision, 33). Jean-Paul Sartre, kur tanksat ruse kalonin mbi trupat e njerëzve të gjallë, shkruante në "Liberation" pas vizitës në Bashkimin Sovjetik se "qytetarët sovjetikë e kritikojnë udhëheqjen e tyre shumë e shumë më tepër e më me efektivitet se në Perëndim... Ekziston liria totale për të kritikuar...Qytetarët sovjetikë nuk udhëtojnë jashtë shtetit, jo sepse nuk i lejojnë, por ngase nuk dëshirojnë ta lënë qoftë dhe për pak kohë vendin e tyre të mrekullueshëm". Disa vite më vonë, ky idiot savant, siç e konsideron më vonë Solzhenicin, pat pohuar se aso kohe ai e dinte se po gënjente, por gënjente, ngaqë nuk donte t'ia prishte autoriteteve komuniste. Po ky Jean Paul Sartre pat shkruar një herë tjetër, kur tek ne kishat dhe institucionet fetare po rrënoheshin me një zell të frikshëm, se Shqipëria është i i vetmi vend i lirë në

botë! At Zef Pllumi, me dy librat e tij madhor për Historinë, për fat të mirë, ec në gjurmët e një tradite tjetër, e një tradite të hershme, në gjurmët e shkrimit të kronikave nga murgjet evropiane, duke filluar me "Historinë e Kishës" të grekut kristian Eusebues (c 260-339), dhe duke vazhduar me anglezin Venerable Bede (d735), me Jean Froissart (C.1337-C.1410), me Lorenzo Valla-n (c.1407-57), me Leonardo Brunin. Libri i këtij të fundit, Historia e Firences (1415-29) shërben dhe sot si një burim i vlefshëm parësor për të studjuar humanizmin në Rilindjen italiane. Ec në gjurmët e Guicciardinit dhe Sir Ëalter Raleigh në Angli. Në gjurmët e paraardhësve bashkëkombas Marin Barlecit, Frang Bardhit, dhe Pjeter Bogdanit, der te Shtjefen Gjeçovi, arkivisti Pal Dodaj, Marin Sirdani, Anton Arapi, Bernardin Palaj, Benedikt Dema...Në kohnat fatlume kur jetonin këta njerëz, kuptimi i së vërtetës historike ishte i barabartë me konceptin e Shën Agustinit si shpalsosje e vullnetit të Zotit.

Përparësia e At Zefit si Historian asht dija e thellë e Historisë së Shqipnisë, një dije e përfueme dhe e stërvitun në arkivat françeskane, nga leximi i dorëshkrimeve të ruajtuna, nga bisedat dhe nga njohja me disa nga personazhet ma të rëndësishëm të Historisë e të kulturës së Kombit, par dhe nga një përvojë vetjake e jashtëzakonshme...

Historia te ai nuk vjen si dije akademike, si kategori e para-përcaktuar, për shkak të para-përcaktimeve ideologjike; e nga që nuk asht e tillë, Historia për të asht në rradhë të parë Historia e fateve njerëzore. Lexoni librat e historisë të shkruar nga Historianët tanë. Personazhet historike janë monumente, jo njerëz të gjallë. Në librin e mirënjohur të John Julius Norëich mbi Bizantin flitet hollësisht rreth grave të Perandorëve të Bizantit, për karakterin e tyre, për pamjen fizike të tyre, për origjinën e tyre.. Po Ismail Qemali ynë a pati grua? Këtë lexuesi shqiptar ka për ta vuajtur për një kohë të gjatë si një enigmë të pazgjidhur. At Zef Pllumit, ashtu si paradhësve të vet të mëdhenj, as nuk i shkon ndërmend që të vejë në dyshim randësinë e jashtëzakonshme të dokumentacionit, të faktit historik,



**AT ZEF  
PLLUMI**





**AT ZEF  
PLUMI**

**56**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

në shkrimin e Historisë. “ Frati i Pashallareve Bushatli të Shkodrës” fijian me rrëfimin e fatit të një kronike që paska qenë ruajtur në arkivin françeskan; asht kronika e jetës së Fra Erasmus a Balneo, një frat italian që vjen në Shkodeë me misionin e nje françeskani e qe caktohet Famulltar në Hot, për t’u gjetur dëshmitar në një nga periudhat më interesante të historisë së vendit tonë, e në të njëjtën kohë, ashtu siç ndodhë si rregull në historinë e Shqipnisë, duke qenë një periudhë kyçe- një nga periudhat ma të padokumentueme. Dorëshkrimi ka humbë, ashtu si pjesa më e madhe e Arkivit françeskan. At Zefi ri-prodhon dorëshkrimin ashtu siç e kujton. Pra kronika e Padër Zefit asht kronika e një kronike që paska qenë shkruar e që ka humb, asht dorëshkrimi i një dorëshkrimi. Por saktësia dhe objektiviteti i kronikës janë të tilla, sa mbas vdekjes së Padër Zefit, studjuesi arbersh Italo Sarro ka zbulue ne Arkivin Historik te Propogandes Fide ne Rome korrespondencën - përkatesisht 6 letra - qe Bushatllinjt e Shkodrës dhe Ipushkvi Gjergj Radovani i drejtojnë Selise se Shenjte. Letrat jane botuar me Faksimile ne Hyllin e Drites. Do mjaftonte veç leximi i ketyne letrave qe dhe skeptiku ma i thekun t’i besonte vërtetsisë historike të Fratit te Bushatlinjve.

Vetë proçesi i kalimit të fakteve dhe ngjarjeve të së kaluarës në kthesën narrative-linguistike bahet me një natyrshmëri të jashtëëakonshme. Gjuha e padër Zefit asht e çveshun nga rrakaxhinget metaforike. Asht gjuha me të cilën flasin dhe sot e ksaj dite malsort shqiptar. Toni asht i shtruem, i qetë, i mençur. Asht gjuha popullore e pajtuese me nje tekst Historie.. Kallzimet e misionarve te vjeter jane nje pikturë realiste e nje Shqipnie te çoroditun, “me male te egra, me nje popullsi te vrazhde e të pashkollueme, me shumë ngatrresa e provokime mbi të cilat bazoheshin akuza e çpifje që mund të mbërrishshin deri me deke...me kristiane laramana te cilët ditën ose sheshit ish in turq e muslimanë, ndërsa natën ose mesheftas kishin besimin katolik”. Historia e Shqipnisë e padër Zefit nuk e pranon mitizimin, por ajo nuk bie as dhe ne grackën e një çmitizimi që shumë lehtë mund të quhet mitizim i



çmitizimit. Ne traditën e kronikave të murgjeve, të Historitë e at Zefit, bie në sy përultësia si toni i të rrëfytimit, si e kundërt me gjykueshmërinë. Jo përultësia si kategori morale, por si objektivitet i kallximit të Historisë. Tekstet e Historisë, sidomos tekstet e shkruara nga Historianët tanë, janë të mbushuna me gjykimet e guximshme të autoreve për figurat historike e për ngjarjet historike. Fridrih Shileri përmend at historianin që asht me rrufe e që tërheq hundt e teshtin gjatë gjithë kohës tek kritikon përpara studentave Hanibalin për gabimet taktike në kalimin e Alpeve.

Ashtu si gjatë gjithë Historisë njerzore, humori shfaqet në Historitë e padër Zefit gjithmonë atje ku parashikohet tragjedia. Dhe humori asht brishtësi, butësi dhe delikatesë shpirtnore. Pa të cilat dhe vetë Historia do të që një materie e ngurtë, e pajete, e mumje-zueme.

5. ...Me 4 dhjetor të vitit 1354, perandori i famshëm bizantin John (Ioannes) Cantacuzenos, bash në kohën e lavdisë së vet, gjatë një ceremonie solemne në Blachernae, pat vendosë në një qoshe kunorën dhe mantelin e purpurt perandorak. Në vend të rrobave madhështore të perandorit bizantin, ai pat vesh rrobën e zeze të murgut. Po atë ditë e shoqja e tij, Irena, u shugurue murgëshë në Manastirin e Shenjtës Martë. Ai vetë, duke pasë përbuzje për çdo gjë të mëparshme të jetës së vet si Perandor, kërkoi të ndryshonte dhe emnin. Zgjedhi, për një koinçidencë, emnin Zef. Ish-perandori i Bizantit do të jetonte dhe 29 vjet të tjera. Gjate këtyne viteve, kur Bizanti do ndodhej në udhëkryq ngjarjesh, bashqytetarët e vet do shkonin jo vetëm një herë, për t'ju lutë murgut të perulun lef që të kthehej prapë në Fronin e Perandorit. Por ai do refuzonte me kokfortësi. Vitet e para në Manastir ja kushtoi shkrimit të kronikave që ai i quajti "Historina". John Cantacuzenos, tek veshte rrobën e përultë të murgut atë ditë të Dhjetorit të vitit 1354, me qellim që të bëhej kronikan, shpallte kësisoj se dëshmia historike, evidenca, kronika, dokumenti, kanë me rëndësi jo veten nga profesorët e Cambridge-it dhe të Harvardit, por dhe se nga vetë pushtetet e përkohshme perandorake.



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**58**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



Nga Mark MARKU

## ETIKA E SHKRIMIT TË AT ZEF PLLUMIT

**D**uket si një paradoks fakti që pikërisht në Shqipëri në vendin që ka përjetuar krimet më të mëdha të regjimit komunist, dëshmitë për këto krime janë më të pakta se në çdo vend tjetër të ish-kampit komunist të Lindjes. Kjo mungesë reflekton sa frikën për ta thënë të vërtetën, edhe pasi shkaktarët e kësaj frike e kanë humbur pjesërisht pushtetin në shoqërinë shqiptare dhe në opinionin publik, aq edhe mungesën e vetëdijes dhe të pendesës për atë që ka ndodhur. Mungesa e kësaj vetëdije normalisht ekziston tek autorët e këtyre krimeve dhe kjo nuk ka pse të na habitë, por e çuditshme është se ajo ekziston edhe te publiku. Duket se ata që nuk kanë pranuar t'i ndajnë vuajtjet me të persekutuarit, tashmë e kanë shumë të vështirë të ndajnë me ta të paktën të vërtetën e këtyre vuajtjeve.

Kampanet e përqendrimit thotë Anah Arendt tek Origjina e totalitarizmit janë institucioni kryesor i regjimeve totalitare. Rrjedhimisht edhe përshkrimi i

tyre është kusht i domosdoshëm për të njohur natyrën e këtyre regjimeve. E vërteton këtë leximi i Primo Levit, Solzhenicinit, Chalamovit dhe autorëve të tjerë që kanë arritur t'i mbijetojnë terrorit të kampeve naziste dhe komuniste dhe të dëshmojnë për të. Leximi i dëshmimeve të këtyre autorëve e ka tronditur botën dhe ka shërbyer si një moment vetëdijesimi për krimet e kryera nga regjimet autoritare. Por shoqëria shqiptare ka mbetur e pandjeshme ndaj dëshmimeve të tilla. Ajo ka patur frikë të përballet me këtë lloj leximi. Kjo ka ndodhur sepse në Shqipëri ka patur një politikë harrimi të krimeve të komunizmit. Kjo politikë e ndarë në tre etapa a) fshehja dhe manipulimi i provave b) relativizimi i krimeve dhe shpërndarja e fajit c) harrimi i asaj që ka ndodhur, ka bërë që dëshmitë e burgjeve shqiptare në mos të zhduken, të jenë një kategori e marginalizuar e shkrimeve për diktaturën.

Duket se kësaj politike nuk i kanë rezistuar as një pjesë e të mbijetuarve të burgjeve dhe kampeve komuniste në Shqipëri. Përveç dëshmimeve të Petro Markos, Fatos Lubonjës, Kalakullës, Agim Mustës, Maks Velos dhe të ndonjë tjetri, krimet dhe terrori komunist janë përshkruar shumë pak nga viktimat e mbijetuara të këtij terrori. Kjo, sepse siç thotë një disident rus, të dënuarit e komunizmit e kanë përjetuar dy herë izolimin: njëherë në kohën kur kanë qenë të dënuar dhe njëherë pas daljes nga burgu. Dënimi i pasdaljes nga burgu si duket vazhdon edhe kësaj dite. Një nga format më elegante të zgjatjes së këtij dënimi është përpjekja për ta mbyllur parantezën e burgjeve shqiptare.

At Zef Pllumi me librin e tij Rrno vetëm për me tregue, na e hap edhe njëherë këtë parantezë. Vëllimi i parë i librit të tij i botuar në vitin 1995 doli pikërisht në momentin kur dukej sikur politika e harrimit kishte triumfuar. Libri i tij ishte mahnitës, sepse ndryshonte kryekreje nga retorika e përgjithshme mbisunduese antikomuniste e asaj kohe. Kjo retorikë kishte prodhuar një ligjërimit fals, manipulues, fshehës dhe justifikues të krimeve komuniste. Pre e këtij ligjërimit të shpikur nga arkitektët e terrorit komunist ishin si të majtët, ashtu edhe të djathtët, dhe thelbi i tij qëndronte në një



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**60**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

denoncim të përgjithshëm, të paadresuar të krimeve komuniste. Qëllimi i shpikësve të kësaj retorike ishte fshehja e mozaikut të krimeve të diktaturës komuniste pas të cilave konturoheshin qartas autorë dhe fajtorë konkretë.

Arno vetëm për me tregue e denoncon krimin komunist duke e përshkruar atë ashtu siç ka ndodhur dhe ky është akti i parë moral i autorit. Në këtë kuptim e konsideroj këtë libër një kthesë morale në shkrimet shqipe për diktaturën. At Zef Pllumi, nuk sajton, nuk i bishton asaj që ka ndodhur. Rrëfimi i tij është i pamëshirshëm, i ashpër, i drejtpërdrejtë. Gjuha është po aq e drejtpërdrejtë dhe duket sikur autori i ka kthyer statusin e saj primordial: të thënë. Ajo thotë në mënyrë transparente atë që ka ndodhur. Dhe ajo që ka ndodhur është e tmerrshme. Prandaj duhet thënë. Tërësisht e kundërta e ligjërimit mbizotërues. Ligjërimit mbizotërues thoshte se, meqenëse ajo e vërtetë ishte e tmerrshme ajo nuk duhej thënë.

Akti i dytë i fortë moral është se libri i tij është një libër jokomunist për krimet komuniste. Gjejmë në këtë libër gjurmët e një dije tashmë të zhdukur, të dijës së traditës shqiptare dhe botërore që buron nga një mendësi jototalitare, plurale dhe që prodhon një qasje të pandotur ndaj realitetit dhe reales. Ky realitet është përshkruar nga një mendje jo komuniste dhe kjo vihet re në përshkrimin e fakteve dhe në portretizimin e figurave, në momentet e refleksionit në gjithë strukturën e veprës. Ja pse ajo është një vepër kaq papërcaktueshmërisht mbresëlënëse. Duket se je në një kohë tjetër. Në një kohë tjetër të pandotur nga komunizmi.

Akti i tretë moral dhe që buron nga i dyti ka të bëjë me faktin se kjo vepër është vepra e parë, ose modeli i parë i veprës së shkruar në Shqipëri pas gati 50 vjetësh, që është e kundërta e modelit të veprës së realizmit socialist. Mjafton të shohësh për këtë se si shfaqen në këtë vepër figura e të mbijetuarit, figura e persekutorëve dhe figura e regjimit. Në ndryshim nga pjesa më e madhe e shkrimeve për kampet, ky libër nuk ka si qëllim ta ngrejë autorin në rangun e heroit. I vetëdijshëm me sa duket për kotësinë e një gjëje të tillë (At Zefi thotë diku

se fjala hero nuk ka lidhje me shqipen), ai merr përsipër të dëshmojë. Dëshmitari është një njeri, një njeri që ka vuajtur, një njeri që është frikësuar, një njeri që ka qëndruar. Bashkëvuajtësit e tij gjithashtu. Ka prej tyre që janë thyer, ka prej tyre që kanë bashkëpunuar dhe janë përdorur nga xhelatët, ashtu siç ka të tjerë që kanë rezistuar me heroizëm. Ai i dëshmon edhe vuajtjet, edhe heroizmin, edhe thyerjen e tyre. E njëjta gjë ndodh me figurën e persekutorit. Ai nuk është vetë regjimi. Ai është në ndonjë rast edhe i mirë siç ndodh me operativin e sigurimit në Dukagjin, në shumë raste edhe i zgjuar, e në më të shumtën e rasteve një instrument vrapar i kontrolluar nga regjimi. Vizatimi i tij nuk është monokron. Kjo është e shpjgueshme. Autori ka dashur të na sjellë të gjallë dhe në mënyrë joshkematike figurën e të persekutuarit, të persekutorit dhe të regjimit. Ai nuk ka dashur as t'i zbkurojë, as t'i përkeqësojë ato. Ceslav Milosh duke komentuar etikën e shkrimeve të kampeve naziste në epokën sovjetike e shpjegon kontradiktën e këtij përshkrimi dhe kjo kontradiktë, sipas tij, kishte të bënte me faktin se të mbijetuarit i përshkruanin kampet jo ashtu si i kishte parë, por siç duhej t'i kishte parë. Libri "Rrno vetëm për me tregue" është në këtë kuptim krejt e kundërta. Në këtë libër nuk është ideologjia ajo që e përcakton shkrimin, por fakti.

Me veprën e tij Padër Zefi dëshmon se nuk ka patur asnjëherë frikë të përballet me të vërtetën, as kur ishte në burg, as kur ishte jashtë tij. Nuk ka gjë më të turpshme në botë se të harrosh krimet – thotë Chalamov në një letër dërguar Pastërnakut në vitin 1956. Libri Rrno për me tregue e shpëton shoqërinë shqiptare prej këtij turpi. Ajo është mbi të gjitha një dëshmi se morali i shkrimit ekziston ende në shkretëtirë morale të quajtur Shqipëri që ka lënë pas komunizmi.



**AT ZEF  
PLUMI**



AT ZEF  
PLUMI

62

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



Nga Kolec ÇEFA

## TUE KUJTUE PADER ZEFIN!

**P**ader Zefin e kam njoftë qysh femije, por atehere na ishte ba mendja Pader Justin, Pader Marin, Pader Viktor, Pader Donat etj; e fra Zefi, si e thirrshim na, rrinte i qete ne shezlongun e vet e studionte ne heshtje. Rralle rrijshim me te, por edhe ai shpesh nuk shifej. E kush e dinte se ku shkonte Fra Zefi. Ndoshta, vetem Provinciali. As Justini qe banonte me te ne nje kuvend e i ndante dhomat e tyne nje koridor i gjane dy-tre metrash, nuk e dinte se Fra Zefi, me 1956, ishte shugurue meshtar tinez. E pra, Justini pergatiste fshehtas dy studente per meshtarë. Dy vjet ma vonë, kur u lejue te thonte meshen ballafaqas, Pader Justini shkroi keto dy epigrame gezimi qe tingellojne, si nje prôtëste e kjarte disidence, vertet e heshtun, por denoncuese, e forte, kambengulese. Epigramet botohen per here te pare. Doreshkimin e kësaj veprë, e para e llojit ne letersine tone, e kemi gati per botim, perkthimin e epigrameve etj. nga latinishtja i ka ba perkthyesi, leksikografi e poliglotti Zef Simoni.

Ja dhe epigramet kushtue Pader Zef Pellumbit:  
*Ndërsa keqas vorfenue  
 kryeultë ne gryke te vorrit vojton  
 mjerimin qe e kish' mbulue  
 e shumja moj province idhtas po kjante.  
 prej dhimbet se naltit Hyjit i pelqei  
 zemrat me na i ngushlluem  
 me shugurimin tand p. Zef, faret te papritun  
 mbi te gjithë por ti meshtar i zotit gezoju  
 qe mbas sa vjetsh dihamesh, pezullimesh  
 deshiri te shkoi ne vend  
 njai Krisht qe se parit sot nder duer te dirgjet  
 te forcofte, te zemrofte, shok t'u bafte  
 n' apostullimin e nalë qe te pret*

Rasa historike: mesha e pare e fra Zef Pllumit,  
 më 1 maj 1958:

*Me gaz e hare shoke e miq mblidhuni  
 Ejan! Te lteri i shenjte ne te cilin  
 I nderuemi at Zef Pllumi OFM  
 Kete dite ma se fundi  
 I patrembun nga veshtirësite e kohes  
 I rrethuem nga njerezit e dashun  
 Çoi meshen e pare*

*Jezusi zemerbute e Mbretnesha e Qiejve  
 Te qofshin prane*

*Qe të vështirën detyre te shenjtë  
 Ta mbash e ta kryesh me zemer te forte*

Po sjell momente nga kujtimet e Z.Pllumit! - Une nuk e kam njoftë Dom Ndrene, por kam ne memorien time atmosferen e tij. I ka dhane mesim gjuhët vëllait tim., i cili, thoshte, se ishte teper terheqes e klasa e ndiqte me nje vemendje te madhe. Fliste rrjedhshem e thjeshte dhe leksionet e tij perfundojshin tue ece rrugdash dhe oborresh, sepse kujtonte ngjarje, skena e prapaskena te historise se vendit tone. Nje dite ne megjes, posa shkova ne shkolle, ndjeva atmosferen se ka vdeke Dom Ndreu. Une nxitova kah dera e kuvendit te jezuiteve dhe tue kalue rremujes qe muntohej te getesonte Mark Manovi, portieri, me ate te folun



**AT ZEF  
 PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**64**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

mllaqites, por qe ngelet per ne simboli i besnikerise e i thjeshtesise. Ne korridorin e erret i kalova tue vrapue te gjitha dyert e zeza. Njena nder keto dyer kishte nje xham. Aty u ndala. Ne nje tavoline te gjate kishin vendose Dom Ndrene e vdekun! I madh, imponues, me mustakt e medhaj e buzet e shpervjeluna. Kam ndeje mbas xhamit per ma se gjysme ore, sepse dojshe ta mbaje ne mend figuren e tij per te gjithë jeten. Ate figure e kam te qarte edhe sot dhe di edhe ta vizatoj. Njeriu ne jete ka shume mllefe, qe shpesh e ndjekun edhe me vite. Si kam mbete i indinjuem, kur kam lexue ne nje hyrje te nje botimi per Mjeden, sesi rinia perparimtare ua rrembeu trupin e Mjedes jezuiteve per t'i ba nje funeral madheshtor. S'ka kene hiç ashtu. Mjeda ka vdeke nder jezuite dhe, sipas zakonit e rregullave te tyne, ata e vejshin mes kishes se tyne, njerezit e vizitojshin dhe, kur vinte ora e caktueme, bahej salikimi i te vdekunit. Me nje gusht kane ndodhe per pushime te gjithë studentet universitare, qe mesojshin ne shkollat e nalta te Europes. Shume ishin letrare te rij, qe Mjeden e kishin pase mesues. Nje perfaqesi e tyne (mbaj mend edhe emnat): Henrik Lacaj, Nard Kraja, Pashko Gjeçi e disa te tjere, shkoi tek Imzot Thaçi dhe i thane se duem t'i bajme nje homazh poetit te madh, tue i ba nje funeral te thjeshte neper rruget kryesore te qytetit. E Thaçi: Posi, po vij edhe une me ju! - Kush e ka njoftë kete figure patrioti, me inteligjence e gojtari te rralle, i forte, burre karakteri, qe krijonte respekt te madh ne paraqitjen e tij, i jep vendin e merituem, si klerik e si patriot i rralle. Sigurisht, qe Thaçi "plasi", me 1946, sepse u gjend para nje suate te pakonceptueshrne. Ashtu fjale pak siç ishte i komunikojshin çdo dite vrasjet e burgosjet e priftave te tij. E mbaj mend si çohej ne kambe dhe ecte kryenalte neper korridoret e arqipeshkvisë. Sigurisht, se me kater rreshta nuk pershkruhet nje figute kaq e madhe. Per nje'gja jam i sigurte se, kur te shkruhet historia e vertete e vendit, do te dale roli i madh i Thaçit ne "çlirimin e Shkodres" dhe ne qofte se Shkodra asht çlirue pa asnje pushke, asht vepra e Imzot Thaçit. Une e mbaj mend ne ditet e fundit te nandorit 1944, kam pa oficerin e nalte gjerman tue hy ne arqipeshkvi dhe mbas ka hy tek nje



personalitet i Luftes Nacionalçlirimtare. Ajo marrevshje me leshue Shkodren pa gjak asht veper e Thaçit e Shkodra, duhet te jete mirenjohese perjete. Kush i di ma mire keto pune, le t'i shkrueje!

Te kthehemi tek funerali i Mjedes. Gjithe populli i Shkodres me desipline e dinjitet e suell neper qytet. Ne Fushe te Qeles, qe ishte hape krejt, para postes, ndalin arkivolin mbi nje si sarkofag dhe ne ballkonin e vogel, pese-gjashte kambe shkalle foli prof. Ernest Koliqi. Foli teper bukur, ma teper ne poezi se ne proze. Bile une, ishe afer bandes (pse ku mund te ishe une?). Duket se drejtuesit e bandave nuk me debojshin, si femijet e tjere. Nder fotografite e asaj ceremonie ne Fushe çele, shifet pralle bandes nje djale i vogel, ai jam une.

Mjeden e vorrosen ne vorrezat e jezuiteve ne fundin e kishes se tyne. Me duket se asht detyre e secilit ne Shkoder t'ia kujtoje autoriteteve se ku gjindet vorri, se prane tij jane edhe tjera figura te shqueme te kultures sone kombetare: Zanoni, Jungu, Pazi e sa e sa tjere. Se ku ishin ata te rij revolucionare qe ua "grabiten" Mjeden jezuiteve, une as i pashe, as me kujtohen.

Mjeden e recitojshim ne familje te gjithe, nganjehere edhe te gjithe se bashku, po ashtu edhe te dajat. Une kisha ndonje poezi qe nuk u merrshe vesh dhe m'u desh kohe, bile vjet ta deshifrojshe. Kur nje dite, nje kushri imi, teper i mire, teper i bute, ishte inxhinier pyjesh, ulet ne tryeze e me spjegon tubëzën e dyte te "Andrra e jetes", se e shifte se une ate poezi nuk e kuptojshje: "Krekce e bre, e çetine e qeparize etj. S'kuptoja asgja. Shiko, me Ilia: "Keto jane lloje drujsh qe nuk rriten, absolutisht, afer njeni-tjetrit, por Mjeda me inteligjencen e tepert ka krijue nje vend e nje panorame qe te permblihdhte sa ma teper bukuri te vendit tone. Edhe sot e kesaj dite (ah, force magjike e artit!), kur e lexoj Mjeden, me kap nje ngasherim shpirtnor. Here me ban te fundosem ne detin e madh te veshtiresive te jetes: malli, internimi, pritja, vdekja, kujtimet e largeta, disa te pasherim, luftat, por pastaj e ndiej veten me nje perbamje tjetër ku Skenderbeu e keshtjella, ku legjenda e miti, ku lavdia e Lezhes dhe e Shkodres, shperthimi i lirise kane krijue tek ti, vertete, pjesetare te nje ~ombi



**AT ZEF  
PLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**66**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

me origjine hyjnore. Une e ndiej tek poezia e tij "burrin", Fatosin ne patershane tue preke, kete monumentalizem, me gjithçka, jo vetem ne figura madheshtore, por edhe vete ne konceptimin e skenave (Lissus), ne konturet e forta. Me duket se shqiptari e ka te kjarte e te lehte te baje basorilievat e historise ne momentin gjigand te atdheut.

Ato basorelieve nga poezia epike e Mjedes, besoj se do te jene ma madheshtore se ato qe veshin kolonat greke apo romake; ata do te jene, se paku, ma te verteta. Kush e njohu Mjeden, thote se ai kishte nje karakter shume te c;uditshem, ishte idhnaq, rebel, nervoz dhe me gjithte ate volum te trupit (e me gjithte ate virtyt e perkushtim shpirtnor) kishte veshtire ta fshihte. Edhe ate mlllef te periudhave te ndryshme, ai na i la ne poezine e vet:

*T'trembne ne Stambolle, o tiger*

*E t'farmakuene gjumin!*

*Keqas, O i mjere, ti lumi*

*Me prite ke ba mendim...*

*Nganjehere me merr me vete, me zor, e me çon tek nje mal i madh e me len te besoj ne te ardhmen:*

*Mblidhnu vellazen e bashkonju*

*Nen flamur te shqiptaris,*

*Prej nje gjaku, nje gjinis*

*Asht shqiptari kand e kand.*

*Une po mbeshtes kryet ne gjoksin e tij e po lexoj:*

*Nje nane tjetër, thoshe, ke*

*Bir, ne kete dhe*

*Nana jote asht shqiptaria*

.....

*Mbas fjalesh te tua perhere shkova*

*E t' ndiqjova, Shqyptarine nuk e korita.*

Na fal, O Dom Ndre, sepse me duket se te kemi njohe pak e te kemi çmue pak! (3.VI.1992). E une po e mbylli tue perserite: Na fal, O Pader Zef, nuk te paskemi njoftë e çmue sa duhet! "Deshmia jote do te mbese e gjalle e do te kujtohet, e te mos harrohen krimet e diktatures, qe te mos perseriten. Deshmia jote me duket sikur me thote: mos mbaje inat, mbaji ne mend!

Por, "Të harrojme, tue i kujtue"!



Momenti i arrestimi të At Zef Pllumit



Nikollë Mazreku dhe At Zef Pllumi në gjyq



**AT ZEF  
Pllumi**


MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**67**



“Nder i Kombit”





**AT ZEF  
PLLUMI**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**69**

Dy veprat madhore të At Zef Pllumit







**AT ZEF  
PLLUMI**

**70**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



## Lamtumira e At Zef Pllumit





**AT ZEF  
PLLUMI**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

**71**

# **PADRE ZEF PLLUMI**

## **TRA LA SCRITTURA E LA STORIA**

---

*La conferenza scientifica dal titolo **“Padre Zef Pllumi – tra la scrittura e la storia”** organizzata dall’istituto delle Ricerche Politiche “Alcide De Gasperi”, la Provincia Francescana albanese “Zonja Nunçiatë”, l’Universita’ di Tirana ed il “Centro degli studi albanologici”.*

---

*25 Settembre 2008*



**AT ZEF  
PLUMI**

**72**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

---





**AT ZEF  
PLLUMI**

## “PADRE ZEF PLLUMI – TRA LA SCRITTURA E LA STORIA”

*Nella piu' grande sala del Museo Nazionale a Tirana due sessioni scientifiche hanno trattato nei dettagli i valori ed i messaggi dell'opera del frate francescano nel primo anniversario della morte.*

**H**a terminato con successo i lavori la conferenza scientifica **“Padre Zef Pllumi – tra la scrittura e la storia”**. Con la partecipazione di numerosi invitati nella sala centrale delle conferenze del Museo Storico Nazionale a Tirana si e' svolta la conferenza scientifica dal titolo **“Padre Zef Pllumi – tra la scrittura e la storia”** organizzata dall'istituto delle Ricerche Politiche “Alcide De Gasperi”, la Provincia Franciscana albanese “Zonja Nunçiatë”, l'Universita' di Tirana ed il “ Centro degli studi albanologici”.

Moderatore era il rettore dell'Universita' di Tirana, Proff. Dott. Dhori Kule. La prima sessione e' iniziata con la relazione tenuta dal Proff. Dott. Sabri Hamiti, noto studioso dal Kossovo dal tema “ Missionario



**AT ZEF  
PLLUMI**

**74**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

ribelle” e si e’ occupato in generale del trattamento delle idee e la trasmissione del messaggio dell’opera dell’illustre frate francescano. Lui tra l’altro ha sottolineato che “il missionario deve pagare il dovere con la vita” alludendo al calvario delle sofferenze di padre Zef Pllumi e di altri missionari cattolici durante il regime monista. La dedizione e il giuramento verso la fede, ha sottolineato il proff. Hamiti ha delineato sempre la vita di Zef Pllumi come scrittore missionario, mentre il suo libro illustra tutta la drammaticita’ di questa dedizione. Parlando piu’ profondamente del ruolo di Padre Zef Pllumi come missionario e come persona che trasmette i messaggi celesti, lui ha ribadito tra l’altro che il prete francescano ha raggiunto il suo scopo, conservando e coltivando l’umano nella folle danza della violenza e della bestialita’. Lui ha diviso l’opera monumentale del frate francescano “Vivi solo per raccontare” a tre livelli. Il primo viene da lui percepito come vita e sopravvivenza all’inferno (comunista). Il secondo livello e’ vissuto e rivive nella memoria di quanto e’ accaduto, mentre il terzo livello: le righe della scrittura basate nella sopravvivenza e nella memoria per offrire la testimonianza nella sua forma piu’ credibile e con essa l’effetto del reale. Dopo esplicitamente ha messo in rilievo l’obiettivo del libro di padre Zef Pllumi, dove l’uomo viene descritto in situazioni estreme, quando si abbassa a sentimenti di ferocia e quando trasforma la sua specie in “bestia da somma”. Al termine il padre Zef Pllumi nell’analisi del noto critico kossovar accetta il ruolo del missionario, ma si trasforma in un missionario ribelle. La sua ribellione fondamentale nell’opera “Vivi solo per raccontare” e’ una ribellione contro l’oblio, ma il messaggio spazia oltre e rivolge un appello per il perdono ma non per dimenticare.

Nel suo discorso il prete francescano Gazmend Tinaj, rappresentante della Provincia Francescana albanese ha sottolineato nella sua relazione dal titolo: “perdere per vincere” che per cinquant’anni e’ stata inesorabile la guerra tra il diavolo ed il Signore,

Cristo... "Non e' stata quella guerra prebiblica tra San Michele e Lucifero, ma e' stata la guerra del XX esimo secolo, tra il comunismo ateo ed il clero cattolico albanese. E' stata una guerra impari". Il relatore ha dato delle testimonianze sulla vita del frate ed i punti di vista di altri grandi francescani come Prendushi, Justin Rrota, Padre Andon Arapi ed altri. Inoltre ha sottolineato che il calvario delle sofferenze vissute dal padre Zef non e' semplicemente individuale, ma e' il calvario vissuto dalla Chiesa cattolica, definendolo "Il giardino di Getsemmani" un evidente riferimento che offre la nota opera di padre Zef Pllumi "Vivi solo per raccontare". La migliore saggezza nel concetto di padre Zef ha sottolineato piu' avanti Gazmend Tinaj - non era la maniera per evitare o scappare della torture, dai problemi della vita, come del resto ogniuno fa' nei giorni d'oggi, ma era la maniera come accettare con amore quello che la scelta della sua vita intendeva e comprendeva. Al termine del suo discorso riporto' all'attenzione di tutti l'ultima volonta' di di Padre Zef che puo essere concepita anche come suo testamento spirituale. Rivolgendosi ai suoi apostoli lui si esprime ina maniera netta e chiara sulla salvaguardia pura dei ricordi sui posti nei quali era passato e che aveva ricordato, trasformati poi in luoghi di persecuzione degli innocenti, e questo lo fa' attraverso le parole:"Conservate accuratamente questo luogo e questa santa casa! Conservate i ricordi di coloro che vi sono stati prima di voi! Sono stati loro ad essere di guida per questo povero popolo con la luce della religione e del progresso, e voi da oggi in poi conservate non solo le loro orme ma anche il loro spirito!

Dopo hanno preso la parola i due traduttori della monumentale opera di Padre Zef Pllumi in inglese e francese e rispettivamente il proff. emmerito Odile Daniel e Kate Schank. Nel suo discorso il traduttore francese la signora Daniel ha sottolineato che nella personmalita' di padre Zef Pllumi si e' incarnata la memoria ed i valori che fanno la grandiosita' di questo



**AT ZEF  
Pllumi**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**76**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË

paese... Questa grande opera ha lei ribadito si contraddistingue per la veridicità. Padre Zef Pllumi non ha voluto lodare se stesso, ma ha voluto testimoniare attuando le parole del suo superiore padre Martin Sirdani nel capitolo "Le rovine della chiesa" quando lui disse "Vivi solo per raccontare". "Il dovere, l'obbligo a raccontare gli anni del sangue e degli orrori che lui ha affrontato con inflessibile coraggio" erano secondo la traduttrice dell'opera in francese, primarie. Mentre parlava delle emozioni vissute quando ha avuto il primo contatto con questo libro, Proff. Daniel venuta appositamente da Parigi ha rilevato che il libro di Padre Zef Pllumi non si limita solo nella denuncia del stalinismo e dei suoi crimini, ma questo libro suscita particolare interesse per conoscere la storia dell'Albania e della sua cultura e questo specialmente nello spazio francofono. Zef Pllumi, ha lei proseguito ha compiuto l'opera della riabilitazione della storia albanese. Lui ha lacerato la cortina ingannevole della propaganda staliniana ed ha raccontato in quale maniera il potere di quell'epoca aveva falsificato il passato. Ma un aspetto molto interessante dell'opera sotto l'angolazione della traduttrice è il fatto che lui ha messo in risalto i valori tradizionali dell'umanesimo nella società albanese espresse concretamente attraverso la solidarietà che il padre Zef Pllumi condivide con i suoi compagni di carcere o nei campi di rieducazione. Altri valori che l'autore del libro incarna nel suo libro sono la parola data e la resistenza. Un valore aggiuntivo che ha lasciato profonde tracce nello spirito della professoressa francese è il senso dell'umorismo Scutarino rimasto intatto nel padre Zef oltre le innumerevoli sofferenze subite.

Mentre la traduttrice del libro in inglese, pubblicato in America, Kate Schank, che si è concentrata nei valori di informazione del libro di Padre Zef Pllumi che in essenza "ha illuminato" le menti nell'Occidente e in America sulla vera situazione regnante in Albania per quanto riguardava la persecuzione della religione e del libero pensiero.

Successivamente ha parlato la signora dott. Dhurata Shehu dell'Università di Tirana, e dopo ha parlato il noto pubblicitista ed editore Fahri Balliu che ha voluto parlare delle relazioni reciproche di collaborazione tra l'opera di Padre Zef Pllumi ed i media albanesi. Lui ha posto l'accento sull'indispensabilità della comprensione dei messaggi che il noto frate francescano ha lasciato a tutti gli albanesi. Interessante era il tentativo di riportare all'attenzione del pubblico la maniera in cui descrive ed analizza le più odiose figure del regime comunista e che paradossalmente ritrovano ancora oggi posto nei giornali e nei quotidiani albanesi.

Nella seconda sessione ha parlato l'ex ambasciatore tedesco degli anni 80 e degli inizi degli anni 90 proff. Dott. Daum, che ha raccontato momenti interessanti sulla sorte degli albanesi in quegli anni nonché il ruolo dei perseguitati politici nel crollo del comunismo. Dopo una serie di noti critici e studiosi emmeriti come il proff. Dott. Ardian Marashi, dal centro degli Studi Albanologici, Dott. Persida Asllani dall'Università di Tirana, Rudolf Marku, Proff.ssa Lida Miraj, Mark Marku dall'Università di Tirana hanno messo in rilievo il valore dell'opera e dei messaggi che Padre Zef Pllumi ha lasciato nell'aspetto del patrimonio culturale, storico, letterario artistico, etico, morale e nella salvaguardia e l'archiviazione dei valori archeologici.

I ricordi di Koleç Cefa, Gëzim Peshkëpia e Tanush Mulleti, hanno fatto rivivere ai presenti pezzi interessanti dalla vita di Padre Zef Pllumi perché loro avevano avuto stretti contatti con il frate franscano.



**AT ZEF  
PLLUMI**



**AT ZEF  
PLLUMI**

**78**

MES SHKRIMIT DHE HISTORISË



Da Fahri BALLIU

## PADRE ZEF PLLUMI ERA SIMBOLO DELLA PERSECUZIONE DEL CLERO CATTOLICO ALBANESE

**P**er me il momento in cui ho conosciuto Padre Zef e' stato un momento felice. E' stata una conoscenza semplice attraverso un suo amico, piu' precisamente attraverso un amico comune con il quale ha collaborato con successo per anni per far rinascere la rivista "Hylli i Drites" e in generale della cultura che questa famosa rivista intendeva diffondere. Da quel momento le circostanze sono state ancora piu' propense perche' Padre Zef viveva nelle case dei miei piu' stretti amici, ma senza mai conoscere il legame che avevano con Padre Zef. Brevemente ho avuto tempo sufficiente, ma ovviamente febbrilmente interminabile per leggere non solo l'opera del padre ma anche il suo spirito le reticenze mai pronunciate. Perche' lui aveva delle cose da dire, mai dette e che verranno dette ora e dopo, ma lui non sollevava tempeste irose nemmeno nel momento in cui qualche bastardo della dittatura che difende i criminali ed i fondatori della securitade

allungava le mani. Padre Zef era un prete che nei suoi racconti appare molto in alto nelle nostre feroci guerre di lingua e di spada. Questo però non significa che non sapeva separare il grano dalla zizzania, ma si impegnava anima e corpo a interrare il conflitto anche nei momenti quando certi schiocchi conformandosi al modello di Peza si struggevano del dialetto gege.

